



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:059050

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05766047

C.nr.171/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri me Bashkëpunëtorin Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësit L. K. nga fshati P./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Ramadan B. Paçarizi nga Malisheva, ndaj të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore Av. Zyle Millaku-Gojnovci, sipas bazës juridike: “Kompensim i shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit”, vlera e përgjithshme e kontestit 2,274.60 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 31.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit L. K. nga fshati P./Malishevë ashtu që **DETYROHET** e paditura Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR) me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë dhe shpenzimeve të udhëtimit, t’ia paguaj paditësit L.K. shumën e përgjithshme prej **2,274.60 euro** (dymijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër euro e gjatshtëdhjetë cent) dhe atë:
- a) Në emër të shujtës ditore të përlllogaritur për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.10.2022 ose për gjithsej 669 ditë pune, t’ia paguaj nga dy euro në ditë, ose shumën prej **1,338.00 euro** dhe
 - b) Në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën e njëjtë nga data 01.01.2019 deri më datë 31.10.2022 ose për gjithsej 669 ditë pune (2 euro bileta për 1 ditë vajtje-ardhje) të përlllogaritur nga 1.40 euro në çdo ditë pune në 70% të biletës, t’ia paguaj shumën prej **936.60 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 21.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi L.K. nga fshati P./Malishevë të cilin me autorizim e përfaqëson av. Ramadan B. Paçarizi nga Malisheva, në këtë gjykatë me datë 26.03.2021 ka paraqitur padi kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, me arsyetimin se paditësi është i punësuar nga data 01.09.2014 në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë dhe në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, i takon e drejta e kompensimit.

Paditësi ka theksuar se ka parashtruar kërkesë te punëdhënësi për kompensimin e shujtave ditore dhe udhëtimit, mirëpo e paditura ende nuk ka kthyer përgjigje dhe duke u gjendur në këtë situatë, paditësi i është drejtuar gjykatës me padi duke shtuar se i takon kjo e drejtë.

Nga arsyet e paraqitura në padi, paditësi ka kërkuar nga gjykata që të obligoj të paditurën që në emër të kompensimit të shujtës dhe udhëtimit, t'ia paguaj paditësit shujtën nga dy euro për një ditë pune dhe 70% të shpenzimeve të udhëtimit dhe atë prej datës 01.01.2019 e deri në nxjerrjen e aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 21.00 euro, si dhe shpenzimet tjera eventuale dhe të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi (nuk e ka kërkuar kamatën).

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura, përmes avokaturës shtetërore me datë 08.05.2024 ka parashtruar përgjigje në padi ku e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa lejuar dhe të pas afatshme. Ka theksuar se lidhur me shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit, e paditura nuk ka pasur buxhet dhe se iu kanë drejtuar Ministrisë së Financave për buxhetimin e kësaj kategorie, mirëpo nuk kanë pranuar përgjigje, ndërsa sa i përket kompensimit të biletave të udhëtimit prej 70%, paditësi nuk ka bashkangjitur prova për ta dëshmuar adresën e banimit, dhe se i njëjti i ka ofruar vetëm dy kupona fiskal.

E paditura vlerëson se asnjë dispozitë ligjore e Kontratës Kolektive nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte, po ashtu mbështetur në dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës, afati i parashkrimit për të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave ta hedhë si të pa lejuar padinë e paditësit, ose në të kundërtën të refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit L. K..

Provat dhe vlerësimi i tyre

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palës paditëse ka vlerësuar dhe administruar këto prova: Kontratën e punës e lidhur mes të paditurës-punëdhënësit AAAPARr dhe paditësit L. K. nr.... të datës 07.12.2016, Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës nr.... të datës 16.03.2021, kopjen e letërnjoftimit të paditësit, Vërtetimin mbi marrëdhënien e punës dhe ditëve prezent në punë nr. prot.687/4 të datës 08.11.2022, kuponët fiskal/biletat e udhëtimit dhe vërtetimin e kompanisë së udhëtimit “Kombi Taxi-N. K.” të datës 08.02.2024.

Ndërmjet palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, shkollë kjo e cilat bie në kompetencë të të paditurës dhe kjo është vërtetuar me kontratën e punës nr.... të datës 07.12.2016 dhe vërtetimin e punësimit nr.1586/3 të datës 16.03.2021.

Po ashtu nga vërtetimi tjetër nr. prot.... i datës 08.11.2022 i lëshuar nga Drejtoria e shkollës, vërtetohet fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se për periudhën 01.01.2019 deri me datë 31.10.2022 ka qenë prezent në punë gjithsejtë ... ditë.

Nga kopja e letërnjoftimit të paditësit me nr. personal ...vërtetohet fakti se paditësi vendbanimin e ka në fshatin P. /Malishevë, kurse nga vërtetimi mbi udhëtimin dhe biletat/kuponët fiskal të lëshuar nga kombi taxi-N. K., vërtetohet fakti se paditësi ka udhëtuar nga vendbanimi i tij (P.), për në vendin e punës-Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë dhe ka shpenzuar 2 euro biletë ditore-vajtje ardhje.

Kontestuese ka qenë nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave dhe udhëtimit për ditët sa ka punuar në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi në Malishevë.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, dhe të njëjtën e ka aprovuar në tërësi për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, po ashtu nuk është kontestuese edhe drejta e kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore dhe kompensimit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën përkatësisht ditët si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Kontratën e punës dhe vërtetimet e lartcekura, gjykata i ka pranuar si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se: “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në*

ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, andaj vërtetimeve dhe kontratës së punës me të cilat është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, gjykata ua fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata ka gjetur se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.01.2021, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.105 të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datën 21.11.2022 kur edhe është anuluar nga MASHT, ku me nenin neni 35 par.7 përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”,* ndërsa lidhur me kompensimin në emër të shpenzimeve të udhëtimit sipas nenit 35.5 përcaktohet se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut rrugor”.*

Andaj, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e kompensimit për shujtë ditore dhe për shpenzime të udhëtimit në shumën e përgjithshme prej 2,274.40 euro dhe atë në emër të shujtës ditore për gjithsej 669 ditë pune, i takon shuma prej 1,338.00 euro sipas formulës 669 ditë pune X 2 euro = 1,338.00 euro dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për 669 ditë pune i takon shuma prej 936.60 euro, të përlllogaritur në 70% të biletës (70% të biletës 2 euro për 1 ditë vajtje-ardhje = 1.40 euro) sipas formulës 669 ditë pune X 1.40 euro = 936.60 euro.

Sipas Mendimit Juridik për Shpërblimin Jubilar të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.40/2023 të datë 27.02.2023, në Pikën e IV të këtij mendimi juridik parashikohet se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovës e datës 18.04.2017 aplikohet për periudhën prej 18.04.2017 deri më 21.01.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit e lidhur me datë 22.01.2021 aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022 kur edhe është shkëputur nga MASHT.

Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarin e saj dhe duke u nisur nga fakti se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj që del nga kontrata kolektive e Arsimit, përkatësisht me nenin 35 par.5 dhe 35 par. 7, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Sa i përket lartësisë së shumës, gjykata u bazua në vërtetimin mbi udhëtimin dhe biletat/kuponët fiskal ku vërtetohet fakti se paditësi ka udhëtuar nga vendbanimi i tij (P.) për në vendin e punës-Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë dhe ka shpenzuar 2 euro biletë ditore dhe gjithashtu u bazua edhe në vërtetimin nr. prot.... të datës 08.11.2022, me anë të të cilit vërtetohet se paditësi për periudhën nga data 01.01.2019 deri 31.10.2022 ka qenë

prezent në punë gjithsejtë 669 ditë, dhe bazuar në këtë vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për këtë periudhë, paditësit i takojnë shpenzimet për shujtë ditore dhe udhëtim në shumën e përgjithshme prej 2,274.60 euro, dhe në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit t'ia paguaj shpenzimet për shujtë ditore për ditët sa ka qenë prezent në punë.

Sipas nenit 8 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitën e nenit 245 par.1 të LMD-së është paraparë se: *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90/01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin në emër të shujtës ditore u vendos që të njëjtën ta aprovoj sipas periudhës së lartcekur, gjatë së cilës paditësi ka punuar tek e paditura, fakt ky që u vërtetua edhe nga vërtetimet e lartcekura dhe në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura nuk e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit për shujtë ditore dhe udhëtim, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme dhe si të tilla janë të besueshme, dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Në dispozitën e nenit 152 të LPK-së është përcaktuar se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, e që në këtë rast e paditura përmes përgjigjes në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare dhe as të drejtat e kompensimit të shujtave dhe shpenzimeve në emër të udhëtimit. Andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, por pretendimet e tilla i konsideroi të pabazuara ngase paditësi, padinë e ka parashtruar me datë 26.02.2021, kurse kërkesa ka qenë prej datës 01.01.2019, në periudhën në të cilën ishin në fuqi Kontratat Kolektive, gjegjësisht Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017 dhe Kontrata

Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021 që aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021 deri me datë 21.11.2022 kur edhe është shkëputur nga MASHT. Pra, nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë e ka parashtruar në të njëjtën periudhë që përkon me kontratën kolektive të vitit 2017 dhe të vitit 2021, ndërsa kërkesa rezulton për periudhën 2019-2022 e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe nga kjo gjendje faktike ndërlikohet me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave, neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcakton se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Pretendimet tjera, gjykata i konsideroi të pabazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa me dispozitën e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën -II- të dispozitivit, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe nenit 453 par.1 dhe 2 të LPK-së ku parashihet se: *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*, si dhe në bazë të rregullores për tarifat e avokatëve, ashtu që vendosi që paditësit t’ia njoh shpenzimet e procedurës duke e detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 125.00 euro dhe atë: në emër të parashkrimit të padisë t’ia paguajë shumën prej 104.00 euro (sipas numrit tarifor 6 të rregullores për tarifat e avokatëve në kontestet me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri ne 10.000 €) dhe shumën prej 21.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.171/21, datë 31.05.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.